

**VENDIM**  
**Nr. 261, datë 7.5.2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 205, DATË 13.4.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,**  
**“PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 199, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 2 e nenit 504, të seksionit 5, të kreut 2, të pjesës III, të vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. “Mallra me vlerë të papërfillshme” do të thotë: mallra, vlera përmbledhëse e të cilave nuk i kalon 20 000 (njëzet mijë) lekë për çdo dërgesë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**